



-97-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**  
**SHKODER**

**V E N D I M**

**Nr. 5 Date 01.06.2007**

**PER ANOLLIMIN E KONTRATES SE KONCESIONIT**  
**NENSHKRUAR NE MES TE PALEVE KRYETARIT TE**  
**K.B.U.DRIN-BUNE DHE PERFAQESUESIT TE SHOQERISE**  
**“MANJANI “ Sh.p.k. QE MBAN DATEN 09.07.2004.**

Bazuar ne germen c, neni 18 dhe piken 1, neni 23, kreu V i ligjit nr. 8093 dt. 21.03.1996 “Per rezervat ujore”, qe shprehet se :” Lejet, autorizimet dhe koncesionet, mund te anulohen, pezullohen ose kufizohen, ne rast se nuk plotesohen ndonje nga kushtet ose afatet e percaktuara ne to”, K.B.U. Drin-Bune, pas shqyrtimit te dokumentacionit per mosrealizim te kushteve te kontrates koncesionit ne mes te paleve, te Kryetarit te K.B.U. Drin-Bune dhe shoqerise “MANJANI”sh.p.k., pasi mori dhe mendimin e K.K.T.-se, bazuar ne diskutimin e anetareve

**V E N D O S I :**

- 1- Te anullohet Kontrata e Koncesionit e nenshkruar ne mes te paleve, te Kryetarit te K.B.U.Drin-Bune Shkoder dhe perfaqesuesit te shoqerise “MANJANI” sh.p.k.,qe mban daten 09.07.2004, per shkelje nga ana e shoqerise “MANJANI” sh.p.k. te neneve 8,10,14,15 dhe 17 te kontrates.
- 2- Bazuar ne nenin 26 “Sanksionet”, te Kontrates se mesiperme per shkelje te nenit 14, koncesionari duhet te paguaj per llogari te A.U.B.-se Drin-Bune per vonesen , penalitetin 0,01 % te vleres te investimit te parashikuar per tu realizuar nga koncesionari qe eshte 1.313.800 lek. Penaliteti ne perqindjen e percaktuar do te derdhet ne numerin e llogarise 317/4302 Dega Thesari per llogari te M.M.P.A.U. Tirane
- 3- Per ndjekjen e zbatimit te ketij Vendimi,ngarkohet A.U.B. Drin-Bune.

**PER A. U. B. DRIN – BUNE**  
**PERGJEGJESI**

Ing. Osman DELTINA

**PER K. B. U. DRIN – BUNE**  
**KRYETARI**

Maxhid CUNGU